





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor për kornizën afatmesme buxhetore KAB 2026-2028

Data: 04.06.2025

Ora: 16:00

Vendi: SHFMU "Idriz Barani", Klinë e Epërme

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Driton Mulaj; Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Shahin Tahiraj;

Ismet Aliu: Përshëndetje për të gjithë. Ne kemi ardhur për t'i dëgjuar kërkesat tuaja për projektet dhe që do të mundohemi ti përfshijmë në buxhet. Ekzekutivi është i obliguar të mbajë takime të rregullta vjetore për hartimin e buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027 dhe 2028. Aktualisht kemi marrë disa informata nga niveli qendror për sa i përket madhësisë së buxhetit. Pjesa më e rëndësishme janë investimet kapitale, të cilat i propozon qytetari dhe kanë për qëllim ngritjen e mirëqenies së tyre. Shifrat janë mjaft të kufizuara, për shkak se ka ndikuar regjistrimi i fundit i popullsisë. Komuna deri vitin e kaluar ka marrë buxhet për 50850 banorë, ndërsa sivjet kemi rënie në 40644 banorë. Kjo ka reflektuar edhe në rënien e numrit të nxënësve, dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në buxhetin tonë. Ne kemi ardhur për t'ju dhënë fjalën juve që t'i dëgjojmë kërkesat tuaja.

Sami Tahiraj nga lagjja Tahiraj: Unë propozoj që të ndërtohet një fushë sporti në lagjen Tahiraj, pasi ekziston edhe prona publike.

Kastriot Osaj nga lagjja Osaj: Ne si lagje kemi mungesë të trotuarit në rrugën kryesore. Po ashtu, nuk ka përfunduar ndriçimi publik dhe ka nevojë të rregullohet edhe kanalizimi. Gjithashtu, ekziston nevoja për një çerdhe për fëmijë.

Sami Tahiraj: Desha të pyes, kush i vendos shenjat e komunikacionit?

Kastriot Osaj: Kush do ta bëjë mirëmbajtjen e subqendrës pasi të ndërtohet?

Mehdi Tahiraj: Kemi nevojë për një rrugë prej 120 metrash, si dhe disa banorë më lart kanë mungesë të kanalizimit dhe po derdhet në rrugë.

Driton Mulaj: Kastriot, ne kemi një projekt për një mbikalim në bashkëpunim me Qeverinë, te Mecint, por ka probleme pronësore. Nëse do të kishte hapësirë këtu tek ju, pasi është brenda katundit, do ta kishim transferuar këtu. Ai projekt ka mundur të përfundojë vitin e kaluar, por problemi i vetëm është prona.

Sa i përket ndriçimit, punimet janë duke vazhduar, por pas përfundimit të shtrirjes duhet të merret një pëlqim nga KEDS-i dhe ky pëlqim po vonon shumë. Megjithatë, do të përfundojnë të gjitha lagjet.

Sa i përket trotuarit, për pjesën lart që e kemi vazhduar kemi pasur disa probleme me Ministrinë, por besoj se diçka do të realizojmë.

Driton Mulaj: Sa i përket subqendrës, ajo është në procedurë të prokurimit dhe besoj se në muajin korrik do të fillojmë me punimet. Këtu do të mbetet vetëm zyra e vendit për nevojat e qytetarëve, ndërsa pjesët e tjera do të jenë sipas projektit që kemi prezantuar.

Kastriot, pas pranimit teknik, operatori do ta mirëmbajë subqendrën për një vit, ndërsa pas një viti mirëmbajtjen do ta marrë "Eko Natyra".

Driton Mulaj: Mehdi, aty janë tri rrugë përfshirë rrugën te bazeni. Po shpresojmë që nga gjysma e korrikut do të fillojmë me punimet. Vitin e kaluar i kemi përfunduar kogja do projekte sa kemi pasur buxhet. Këtë vit ende nuk kemi filluar në Klinë, por do të realizohen këto tri rrugë dhe ai kanalizimi që e di që e kan afëru afër asfaltit. Po i japim përparësi lagjeve që kanë më shumë shtëpi dhe gradualisht do të realizohen të gjitha.

Driton Mulaj: Sami, vendosjen e shenjave të komunikacionit në rrugët magjistrale e bën Ministria, ndërsa në rrugët lokale i vendos Komuna përmes operatorit të kontraktuar.

Ismet Aliu: Drejtor, faleminderit. Ne ju dëgjuam juve dhe shumica e kërkesave tuaja janë të arsyeshme. Do të mundohemi që t'i shqyrtojmë në Komunë, krahas kërkesave të bashkësive të tjera lokale. Por buxheti është i kufizuar dhe duhet të nisemi nga realiteti se sa kontribuon secili për buxhet. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje.



